

DITARI MUJOR

TETOR 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN

FORUMI RAJONAL PËR POLITIKAT E MIRËQEVERISJES, PIRDENI: STRATEGJIA E RE FORCON MURET MBROJTËS NDAJ KORRUPSIONIT

Lidershipi i Evropës Juglindore për Integritet dhe Zhvillim (SELDI) organizoi në Tiranë forumin rajonal mbi Qeverisjen e Mirë dhe Politikat Antikorrupsion. E ftuar në forum, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Znj. Adea Pirdeni vendosi theksin tek Strategjia e re Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, e cila do të udhëheqë punën e përbashkët të institucioneve në forcimin e mureve mbrojtës ndaj korrupsionit. Kjo strategji tha ministrja Pirdeni ka në fokus të veçantë sektorët vulnerabël ndaj korrupsionit, përfshirë pronat, shëndetësinë, tatinet, doganat, dhe arsimin. Për herë të pare, strategjia shtrihet dhe zbatohet ndaj institucioneve të qeverisjes vendore dhe ka në fokus gjithashu promovimin e integritetit në sektorin privat si dhe synon rishikimin e të gjithë kurrikulës së arsimit parauniversitar me qëllim, edukimin me kulturën e integritetin që në moshë të hershme



PROGRAMI KOMBËTAR PRAKTIKAVE TË PUNËS



460 TË RINJ NISIN PRAKTIKAT E PUNËS NË ADMINISTRATË

Në Pallatin e Brigadave u zhvillua ceremonia e mirëseardhjes për praktikantët e "Programit Kombëtar të Praktikave të Punës", program tashmë i konsoliduar dhe në vitin e tij të nëntë, i cili i siguron mundësinë të rinje pjesëmarrës të përfshihen në një eksperiencë pune të integruar e në ndërveprim me profesionistë karriere në administratën publike. Në fjalën e saj, ministrja Pirdeni i cilësoi të rinxjtë si shtyllë themeli të administratës teksa njoftoi se së shpejti do të hapet thirrja për Programin e Ekselencës. Më tej u shpreh se se sistemi i ri i vlerësimit të performancës personale dhe institucionale, i cili është pilotuar këtë vit, do të sjellë përfitime të dukshme në transformimin e administratës publike, me një fokus të veçantë në inovacion dhe meritokraci.

MINISTRJA PIRDENI TAKIM ME OPERATORËT TURISTIKË, ADRESOHEN PROBLEMATIKAT

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni, zhvilloi një takim të hapur dhe informal me përfaqësues të operatorëve turistikë, me qëllim identifikimin dhe adresimin e sfidave kryesore me të cilat ata përballen gjatë përditshmërisë së tyre me administratën publike. Gjatë diskutimit, ministrja Pirdeni dëgjoi problematikat e shfaqura nga operatorët turistikë, duke u përqendruar në mënyrat më të efektshme për të përmirësuar komunikimin dhe ndërveprimin mes tyre dhe administratës publike.



NJË HAP MË PRANË ANËTARËSIMIT, SHQIPËRIA ÇEL NEGOCIATAT PËR GRUP-KAPITULLIN E PARË ME BASHKIMIN EVROPIAN



Shqipëria hapi zyrtarisht grupkapitullin e parë "Themeloret" në Konferencën e Dytë Ndërqeveritare për Integrimin në Bashkimin Evropian. Takimi i mbajtur në Luksemburg shënoi një moment të rëndësishëm për rrugëtimin integrues të Shqipërisë drejt anëtarësimit të plotë në BE. Ministrja Pirdeni, pjesë e delegacionit shqiptar në Konferencën e Dytë Ndërqeveritare, u shpreh se: "Hyjmë tashmë në një etapë vendimtare për të përshpejtuar modernizimin e institucioneve tona dhe konsolidimin e themelive të Shqipërisë 2030 në BE." Takimi shërbeu për hapjen e negociatave me Shqipërinë për grupkapitullin e parë "Themeloret" ku përfshihet: Funksionimi i institucioneve demokratike, Reforma e Administratës Publike, Gjyqësori dhe të drejtat themelore, Drejtësia, Liria dhe Siguria, Kriteret ekonomike, Prokurimi Publik, Statistikat dhe Kontrolli financiar.

Vijon në faqen tjetër >>>

DITARI MUJOR

TETOR 2024

LIDERSHIP DHE QYTETARËT NË QENDËR, MINISTRJA PIRDENI: PO ENERGJIZOJMË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Një qeverisje me në qendër qytetarin, kombinuar me performancën dhe lidershipin janë elementët e nevojshëm për të rritur efikasitetin, performancën e përgjithshme dhe suksesin e administratës publike. Ishte pikërisht ky fokus i konferencës "Transformimi i Administratës Publike: Performancë, Lidership dhe Qytetarët në Qendër" organizuar nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorruptionin, Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim dhe UNDP. Duke përmendur "Programin e Zhvillimit të Lidershipit", Ministrja Pirdeni theksoi se po bëhen përpjekje maksimale për të ndërtuar një administratë të bazuar në meritokraci dhe integritet.



MINISTRJA PIRDENI MERR PJESE NË FORUMIN GLOBAL TË OECD PËR FORCIMIN E DEMOKRACISË ME VENDET E PARTNERITETIT LINDOR

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorruptionin Znj. Adea Pirdeni mori pjesë në Forumin Global të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) për Ndërtimin e Besimit dhe Forcimit të Demokracisë me vendet e Partneritetit Lindor që u zhvillua më 21-22 tetor në Milano, Itali. Gjatë forumit, ministrja Pirdeni prezantoi një pasqyrë gjithëpërfshire të përpjekjeve që po bën qeveria shqiptare për avancimin e reformave me fokus të veçantë në rëndësinë e zbatimit të tyre për të ndërtuar institucione të qëndrueshme, por edhe të besueshme. "Pavarësisht se rajoni i Ballkanit Perëndimor dhe vendet e Partneritetit Lindor përballen me një presion gjeopolitik të ndryshëm, bashkërisht ndajmë disa nga sfidat e konsolidimit të institucioneve dhe thellimit të reformave që sjellin standarde evropiane në vendet tona," theksoi Pirdeni.

PRESIDENTJA E KE URSULA VON DER LEYEN VIZITON TIRANËN: KENI BËRË PUNË TË SHKËLQYER, 920 MILIONË € NGA BE PËR SHQIPËRİNË

Presidentja e Komisionit Europian, Znj. Ursula von der Leyen nisi turin e saj ballkanik nga Shqipëria ku u mikprit nga Kryeministri Edi Rama. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorruptionin, Znj. Adea Pirdeni ishte pjesë e delegacionit shqiptar që mirëpriti Presidenten e Komisionit Europian. Gjatë konferencës së përbashkët për shtyp me Kryeministrin Rama, Presidentja e KE von der Leyen tha se ekipi shqiptar negociator ka bërë një punë të shkëlqyer për agjendën e reformave të përcaktuar nga Bashkimi Evropian ku theksoi se Shqipëria do të përfitojë nga Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor mbi 920 milionë euro..




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRË SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPTIONIN

Vijon në faqen tjeter >>>

DITARI MUJOR

TETOR 2024



DIPLOMOHEN STUDENTËT E PARË NË MASTER EKZEKUTIV PËR NEGOCIATAT NË BE, PIRDENI: KEMI NEVOJË PËR JU!

Në një ceremoni të veçantë u zhvillua diplomimi i parë për 30 studentët e programit Master Ekzekutiv "Negociatat dhe Anëtarësimi në BE", pranë Institutit të Studimeve Evropiane, pjesë e Universitetit të Tiranës. E pranishme në këtë ceremony, Ministria Pirdeni, vlerësoi përkushtimin dhe përgatitjen e studentëve në fushën e integrimit evropian teksa shprehu besimin se kontributi i tyre është i një rëndësie të veçantë për administratën publike në përballimin e sfidave që paraqet procesi i negociatave. "Administrata publike ka nevojë për ju," ishte ftesa e ministres Pirdeni për të sapodiplomuarit.

GRUP-KAPITULLI I PARË "THEMELORET", MINISTRJA PIRDENI NË DIALOG TË HAPUR ME STUDENTËT

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Znj. Adeja Pirdeni zhvilloi një forum të hapur me studentët në Universitetin "Epoka" mbi sfidat e Administratës Publike në kuadër të hapjes së negociatave për Grup-Kapitullin e parë "Themeloret". Ministria Pirdeni foli mbi pritshmëritë konkrete për këtë proces, sfidat që Shqipëria përballet, si dhe rëndësinë e bashkëpunimit me institucionet evropiane. Takimi u karakterizua nga një interes i lartë nga ana e studentëve, të cilët ngritën pyetje të ndryshme mbi sfidat dhe mundësitë që paraqet ky proces për të ardhmen e Shqipërisë në BE.



MBLEDHJA E KOMITETIT PARLAMENTAR TË STABILIZIM-ASOCIIMIT BE-SHQIPËRI, MINISTRJA PIRDENI: REFORMAT, PRIORITET KOMBËTAR

Në Tiranë është mbajtur takimi i 18-të i Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian-Shqipëri. E pranishme në takim, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adeja Pirdeni, foli në emër të qeverisë shqiptare. "Rruja jonë drejt Bashkimit Evropian është më shumë se miratim i thjeshtë politikash; është një projekt kombëtar që na bashkon, një e ardhme e zgjedhur me dëshirë që qytetarët shqiptarë e mbështesin plotësisht dhe që lidh spektrin tonë politik, si pak kauza të tjera," tha ministria Pirdeni. Ndër të tjera, Ministria Pirdeni theksoi përkushtimin e qeverisë shqiptare në luftën kundër korruptionit, si dhe masat konkrete që po ndërmerren në disa fusha me risk të lartë korrupzioni.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN



Ministëri i Shtetit për Administratën
Publike dhe Antikorrupsionin
Adea Pirdeni



mapa.gov.al
adeapirdeni



APirdeni